



Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



05/ Nr/ 5317 / 2019

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT: **DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) KOMUNA HANI I ELEZIT SHPALL;**

## KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLËN E MESME TË LARTË “DARDANIA” PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020**

Nr.	Emri i shkollës	Numri i paraleleve	Nr.i nxënësve	Profili (drejtimi)	Gjithsejtë
1	SHML “Dardania” Hani i Elezit	2	52	Gjimnazi- shoqëror-gjuhësor	52
		2	52	Shkencat Natyrore	52
	Gjithsej				112

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në shkollën e mesme të lartë duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9), dhe
- Certifikatën e lindjes.

### 3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2019/2020, bëhet më datën **24, 25, 26 Qershor 2019** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet, duke filluar nga ora **8.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën: **28.06.2019**

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet më **:01.07.2019**, nga ora **12:00 – 14:00**.

Shpallja e konkursit plotësues për muajin gusht për vendet e lira më: **19.08.2019**

Dorëzimi i dokumenteve për konkurs plotësues bëhet më datat: **19,20, dhe 21 gusht 2019**

Shpallja e rezultateve për konkurs plotësues bëhet më: **23.08.2019**, kurse tërheqja e dokumenteve të kandidateve të cilit nuk janë pranuar bëhet më: **27.08.2018** nga ora **12:00 – 14:00**

#### 4. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
  2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
  3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë
- Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

#### 5. Afati i ankesave

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve nga koha e shpalljes së rezultateve, t'i paraqes ankesë fillimisht drejtorisë së shkollës, e pastaj nëse sërish është i pakënaqur me përgjigjen e shkollës, mund t'i drejtohet Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa. DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.

Data: 24.06.2019  
Hani i Elezit

